



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.10, datë 25.04.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION I OBJEKTIT EKZISTUES 2 KATE I PAVIONIT TË TË
SËMURËVE KRONIKË GRA DHE NDËRTIM I PAVIONIT TË TË SËMURËVE
KRONIKË BURRA, NË SPITALIN PSIKIATRIK VLORË”,
ME VENDNDODHJE BASHKIA VLORË


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion i objektit ekzistues 2 kate i pavionit të të sëmurëve kronikë gra dhe ndërtim i pavionit të të sëmurëve kronikë burra, në Spitalin Psikiatrik Vlorë”, me vendndodhje Bashkia Vlorë, me zhvillues Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OGERTA MANASTIRLIU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA